



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

Subjektet kyçe të përfshira në raportin e revizionit: Institucioni i Shëndetit Publik Klinika Universitare për Radioterapi dhe Onkologji Shkup

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë së llogarisë për të ardhurat vetanake - 531

Qëllimi i revizionit: Nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to janë në pajtim me rregullativën ligjore.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- dobësi në planifikimin, realizimin dhe kontrollin e kompensimit të kushtëzuar për prokurimin e terapisë biologjike dhe mungesa e protokolleve/udhëzimeve mjekësore me të cilët do të vendosen rregulla dhe do të përcaktoen kritere për kyçjen e pacientëve në terapi biologjike;
- regjistrimi i mjeteve dhe detyrimeve nuk është zbatuar në tërësi;

Mendimi i dhënë/konkluzioni*:



Mendim pa rezervë në lidhje me vërtetësinë dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe mendim me rezervë për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante për vitin 2021.

Rekomandimet kyçe:

- terapia biologjike të prokurohet në kuadër të buxhetit të siguruar pas një kontrate të lidhur më parë për prokurim publik dhe e njëjta të përcaktohet dhe t'u caktohet pacientëve sipas mendimit paraparak të kolegjiut profesional;
- zbatimi i plotë i regjistrimit të rregullt vjetor.

Theksimi i çështjes për vazhdimësi dhe pasiguri:

Klinika ka kërkesa të papaguara nga Ministria për shërbimet shëndetësore të kryera sipas programeve për mbrojtje shëndetësor në vlerë prej 161.774 mijë denarë dhe nga ISHP të mbetur në vlerë prej 50.792 mijë denarë në bazë të shërbimeve ndërklinike të kryera, arkëtimi i të cilave është i pasigurt.

Vërejtjet e marra të draft-raportit: Nuk janë marrë vërejtje për Draft-Raportin e revizorit të autorizuar shtetëror numër 25-217/2 nga 06.02.2023.

* pozitive, me rezervë të pavolitshëm të përmbajtur